



---

**PROCESVERBAL NGA MBLEDHJA E KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE**

**Nr. 19**

**Datë: 12. 02. 2021. Ora: 14:00**

**Vendi: Selia e KQZ-së/ Prishtinë.**

**Valdete Daka, kryetare e KQZ - së.**

**Anëtarët e KQZ: Sami Kurteshi, Sami Hamiti, Arianit Elshani, Alim Rama, Eshref Vishi, Ibrahim Selmanaj, Gordana Llaban, Rifat Krasniq, Čemailj Kurtiši, Artan Asllani.**

**SKQZ: Burim Ahmetaj, kryeshef.**

**ZRPPC: Yll Buleshkaj, drejtor.**

**Përkthyes: Argjina Misini**

**Procesmbajtës: Fehmi Ajvazi.**

---

**RENDI I DITËS**

1. Hyrje: znj. Valdete Daka, Kryesuese e mbledhjes së KQZ-së;
2. Aktivitetet e SKQZ-së
3. Aktivitetet e ZRPPC-së
4. -Shqyrtimi dhe miratimi i rekomandimit për akreditim të vëzhguesve
5. 4.Të ndryshme.

---

**1. Hyrje: znj. Valdete Daka, Kryesuese e mbledhjes së KQZ-së**

**Valdete Daka:** Kush është për këtë rend dite? Fillojmë me procesverbalet e mbledhjeve 9, 10, 11, 12 dhe 13, i kemi pasur ne e-maile. A ka dikush vërejtje? Po urdhëro Eshref.

**Eshref Vishi:** Procesmbajtësit ti përcjellën vërejtjet e këtyre procesverbaleve në mënyrë që mos të zgjatemi me këtë pikë të rendit të ditës.

**Sami Kurteshi:** Unë i kam parë këto procesverbale. Dhe unë jam kundër që të vijnë 4, 5, 6 procesverbale në një mbledhje dhe mos të vijnë rregullisht dhe ti lexoj me shumë kujdes unë për vete nuk e di nuk e mbaj mend gjithçka çka ka ndodhur. Prandaj unë jam kundër formës së tillë dhe jam kundër aprovimit të këtyre procesverbaleve në këtë formë. Procesverbali në mbledhjen e ardhshme miratohet vetëm procesverbali i mbledhjes së kaluar asgjë tjetër. Unë, nuk e pranoj më këtë formë të miratimit të procesverbalit.

**Valdete Daka:** Nëse nuk ka dikush vërejtje të tjera. Kush është për miratimin e këtyre procesverbaleve me vërejtjet? Kush është kundër? Miratohen, me një votë kundër ( Sami Kurteshi). Vazhdojmë me aktivitetet e SKQZ-s, urdhëro Burim!

## **2. Aktivitetet e Sekretariatit**

**Burim Ahmetaj:** Sekretariati pas ditës së zgjedhjeve, tashmë gjitha materialet e zgjedhjeve i ka të pranuar në QNR dhe aktivitetet pas procesit zgjedhor janë duke u zhvilluar në QNR sa i përket procesimit të materialit të ndjeshëm. Si dhe procesimit të dhënave nga formularët e rezultateve dhe po ashtu procesin e vlerësimit të pakove të supozuara të shërbimit votues, më konkretisht të votave mes postës. Pra këto dy aktivitete janë duke u zhvilluar në të njejtën kohë në QNR. QNR-ja është e hapur nga dita e diel pra nga 14 shkurti është e hapur dhe do të jetë e hapur për vëzhguesit deri në certifikimin e rezultateve. Aktualisht është duke u punuar me tri ndërrime 24 orë për të procesuar materialin zgjedhor në mënyrë që të kemi rezultatet. Pra arritjet e para të materialit të ndjeshëm kanë ndodhur me 15 shkurt rreth orës 1:30 pas mesnate, gjithë materiali është procesuar dhe konsiderojmë që diku rreth 22 orë e gjysmë ose 23 orë është dashur që të pranohet i gjithë materiali i ndjeshëm në QNR pra nga të gjitha komunat. Nga procesi i pranimit jo gjitha materialet kanë mundur të procesohen të rregullta për arsye të parregullive të cilat janë evidente edhe në raportin i cili do ti prezantohet KQZ-s. Kryesisht parregullsitë kanë të bëjnë me mos përputhjet ku kategoria më e madhe është mos përputhja e nënshkrimeve në listën e votuesve me kusht dhe zarfeve të fletëvotimeve me kusht. Ndërsa kategoritë e tjera të mos përputhjeve janë të evidentuara në raportin e karantinës dhe pasqyrojnë në detaje arsyen pse vendvotimet kanë shkuar në karantinë dhe nga të gjeturat rezulton edhe rekomandimi. Pra në të dhënat preliminare është raportuar se janë 82 vendvotime të cilat janë dërguar në karantinë dhe nuk kanë mundur të procedohen si të rregullta dhe pas

procesit të hetimit nga karantina rezulton se bëhet fjalë për 101 vendvotime. Materialet e të cilave janë dërguar në karantinë dhe kanë të bëjnë kryesisht me vendvotime të rregullta e sidomos pjesa më e madhe ka të bëjë me zarfet e fletëvotimeve me kusht dhe një kategori tjetër ka të bëjë edhe me votat për personat me aftësi të veçanta. Pra janë materialet nga 101 vendvotime.

Nga procesimi i rregullt i materialeve zgjedhore, pra, tha z. Ahmetaj, janë 22,249 zarfe të votave me kusht dhe pasi të procesohen edhe këto zarfe me kusht që janë në karantinë dhe të regjistrohen në sistem atëherë do ta dimë shifrën e saktë se sa do të jetë numri i votave me kusht. Deri në këto momente nga procesimi i materialit të ndjeshëm të formularëve për votat e subjekteve dhe votave të kandidatëve, nga formularët për vota të subjekteve janë procesuar deri më tani 1,661 vendvotime dhe në përqindje i bie 52,23%. Dhe formularët e rezultateve të kandidatëve janë procesuar deri më tani 1,324 vendvotime në përqindje 52,58%. Ky raport i progresit është i orës 12:00 i datës 18 shkurt. Paralelisht me këtë proces janë duke u zhvilluar edhe aktivitetet e tjera siç është skanimi i formularëve të rezultateve FRP, FRK, qoftë për subjekte qoftë për kandidat të cilat janë duku u publikuar në mënyrë progresive në ueb-faqen e KQZ-s dhe aty të gjitha subjekte politike dhe të gjithë kandidatët mund ti shohin rezultatet të cilat janë të skanuara dhe të cilat janë krijuar në vendvotim. Mund t`ju referohen ueb-faqes së KQZ-s. Aktivitet i cili është duku u zhvilluar po ashtu në QNR është edhe vlerësimi i pakove të supozuara me fletëvotime, nga gjithsej 6,702 zarfe deri në tani që janë procesuar prej tyre 4,111 janë të aprovuara ndërsa shifra të tjera janë sipas kategorive që i keni në raport. Se bashku me raportimin nga QNR-ja kemi sjell para jush edhe katër rekomandime, tri rekomandime kanë të bëjnë me materialin nga karantina dhe rekomandimi tjetër është i numrit të vëzhguesve të cilët vëzhgojnë procesin në QNR. Rekomandimi i par i cili ka të bëjë me procesimin e materialeve nga karantina ka të bëjë me zarfet të cilat pas krahasimeve, pas gjetjeve, pas hetimeve në QNR rezulton se një zarf apo më shumë zarfe varësisht nga vendvotimi të cilat i kemi pasqyruar në tabelë rezulton se nuk është respektuar procedura dhe konsiderohet, rekomandimi është që ato zarfe që nuk kanë nënshkrim të përjashtohen te refuzohen. Ndërsa zarfet e tjera që konfirmohet se janë nënshkrimet në listën e votuesve me kusht dhe ato të cilat janë zarfe të fletëvotimeve me kusht të procesohen si të rregullta, pra ky është rekomandimi i parë. Rekomandimi i dytë ka të bëjë për të gjitha materialet që pas hetimit rezulton se nuk kanë probleme dhe si të tilla mund të procesohen si të rregullta. Ndërsa rekomandimi i tretë ka të bëjë me formularët e rezultateve të cilat nuk mund të procesohen te rregullta për shkak se në disa raste formularët e rezultateve nuk janë nënshkruar nga komisionerët pra nga anëtarët e KVV-e. Disa raste janë të pa plotësuara dhe disa raste kanë mundës të shiritave. Në tabelë i keni të specifikuar të gjitha rastet sipas kategorive dhe sipas rekomandimeve. Ndërsa rekomandimi i fundit që ka të bëjë për rritjen e numrit të vëzhguesve në QNR, pra në bazë të nenit 3.2 të rregullës 6/2013,

në të njëjtën kohë lejohen katër vëzhgues nga një subjekt të vëzhgojnë procesin në QNR. Meqenëse aty zhvillohen në të njëjtën kohë paralelisht shumë aktivitete rekomandimi është që të rritet numri i vëzhguesve për një subjekt politik në të njëjtën kohë përfshirë këtu edhe organizatat e shoqërisë civile. Meqenëse shumë shpejt mund të jemi në procesin e numërimit të votave me kusht dhe votave me post rekomandimi është që të shtohen numri i vëzhguesve për aq sa ka tavolina të punës që bëjnë numërimin e votave me kusht, post apo numërime të tjera. Në të njëjtën kohë kemi edhe aktivitete të tjera të cilat duhet pa tjetër të vëzhgohen nga vëzhgues pra të lejohen aq vëzhgues sa mund të ketë aktivitete të tjera pos numërimit të këtyre votave. Këto janë rekomandimet për KQZ-n dhe kërkojmë miratimin nga ana juaj.

**Valdete Daka:** Atëherë kemi disa rekomandime nga QNR-ja. Ndoshta kishte me qenë mirë të fillojmë nga rekomandimi i parë.

**Alim Rama:** Faleminderit për raportin. Kisha kërkuar që para mbledhjes tjetër që të vijnë këto rekomandime një kohë me herët që të kemi kohë ti shqyrtojmë. Se dyti unë edhe sot në mëngjes kam shkuar poshtë, çka po vërej, po e vërej një trend shumë të ngadalshëm të përpunimit të dhënave dhe kisha kërkuar nga sekretariati ti merr gjitha masat që të përshpejtohet dhe të rregullohet procedura në QNR. Po ashtu sot në vend se procesi në ora 8:00, procesi realisht nuk ka filluar deri ne ora 9:00, 9:30 këto vonesa janë tepër të ngadalshme. Se dyti kur po e shoh tek procesimi i formularëve jemi në 55% ne i kemi 120 operator kjo del që për këto kohë një operator në dite i kalon nuk i kalon 2, 3 formularë dhe kjo procedurë të rregullohet që të jetë sa më e shpejt sepse ky proces duhet të përmbyllet në mënyrë të rregullt dhe sa më shpejt që është e mundur dhe në mënyrë më efikase. Është shumë me rëndësi që ne ti kemi rekomandimet me kohë sepse rekomandimet nuk mund të na vijnë për mbledhje.

**Sami Kurteshi:** Unë kam vetëm pyetje për sqarim ku para se të dal këtu kam çështjen e procedura e trajnimit të dërgesave me post në përgjithësi nuk po e quan ndryshe. Nuk di të them a është e ngadalshme tepër apo e shpejt por mua më duket e ngadalshme por sido qoftë. Aty nga biseda që kemi pasur nga çështjet që janë parë aty një çështje që më ka bërë përshtypje është trajtimi i rasteve kur me gjasë janë refuzuar votat edhe pse nuk ja shikuar por rasti është cilësuar si i tillë pse nuk ka dokumente me afat. Tash është çështja se ne këtu si KQZ kemi marr vendim edhe në Kosovë që personat që kanë dokumente të vlefshme nuk ka afat, ne nuk mundemi të bëjmë një trajtim të ndryshëm të personave që kanë dërguar me post me personat që kanë qenë këtu dhe kanë mundur të votojnë me dokumente që nuk kanë afat por janë të vlefshme sepse të gjitha të dhënat i përmbajnë që duhet ti ketë një dokument. Prandaj kisha kërkuar nga KQZ-ja që gjitha rastet që kanë dërguar votat e tyre dhe kanë dokumente pa afat por janë të vlefshme që ato të mos refuzohen përndryshe kishte me qenë një diskriminim në raport me qytetarët që

kanë votuar me të njëjtat dokumente. Nuk kanë afat por janë të vlefshme. Këtë çështje e kisha me kërkuar që të vendos KQZ-ja dhe kam për sqarim shikojeni tash tabelën që e keni përpara ka ardhur në momentin e fundit dhe prandaj edhe unë nuk i kam të qarta i kemi tek numri 14 thotë, të anulohen fletëvotimet. A duhet gjitha fletëvotimet apo ka disa fletëvotime që duhet të anulohen. Shënoni ju unë po bëjë pyetje pastaj ju sigurisht i përgjigjeni. Ose kemi tek numri rendor 44 të anulohen 40 ZFK, të anulohen 37 ZFK, kemi tek 86 të anulohen përsëri fletëvotimet. A bënë të na sqarohet fletëvotimet, gjitha nja nga një apo si është puna dhe pastaj këtu kemi me radhë disa fletëvotime ju i keni parë ato. Janë 12 vendvotime që duhet të rinumërohen nga këto kutit që kanë qenë në karantinë, këto janë nga 81 apo nga 161 në gjithsej.

**Burim Ahmetaj:** Nëse i referohemi materialeve të cilat është rekomandimi të anulohen. Është fjala për procedurën që nuk është respektuar në vendvotim sidomos në vendvotimin e dyfishtë, pra kemi pasur fletëvotimet pa zarfe. Në të gjitha instruksionet në të gjitha materialet ju kemi dërguar në vendvotim dhe instruksionet kanë qenë të qarta që së pari futen në zarfin e fshehtësisë dhe pastaj në zarfin e sigurisë që ka të gjitha të dhënat dhe këto fletëvotime nuk janë respektuar, kanë qenë vetëm fletëvotimin në kuti të votimit. Kanë qenë pa zarfe që i bie mosrespektim i procedurave. Kështu që ky rast nuk mund të trajtohet ndryshe pos që duhet të anulohet. Rasti tjetër ka të bëjë me pasi që nga të gjeturat në karantinë ka pasur mos përputhje të nënshkrimeve mirëpo pasi është hapur thesi me zarfet me fletëvotime me kusht dhe pasi është hetuar është ndërruar komplet procedura në vend se të shënojnë të gjitha të dhënat e votuesve me kusht në listën e votuesve me kusht i kanë shënuar në librin e votimit. Mirëpo është shmangie e procedurave sepse në librin e votimit nuk kemi nënshkrimin e asnjërit prej këtyre votuesve. Prapë kemi një shmangie të procedurës dhe rekomandimi edhe për këtë kategori është që të anulohen të gjitha ato sepse nuk ka nënshkrimin në librin e votimit edhe pse janë të dhënat e votuesve. Dhe rasti tjetër fletëvotimet nuk kanë zarfe por janë të ngjashëm fletëvotimet janë vendosur tek rasti 86 është për votimin me nevoja të veçanta i kanë të vendosura fletëvotimet në kutit e votimit pa zarfe. Pra të gjitha këto raste është mos respektim i procedurës dhe për këtë arsye të gjitha këto edhe pse kanë një sasi më të madhe të anulohen. Pra rekomandimi është që të anulohet. Kjo është shpjegimi për të gjitha këto kategori. Ndërsa tek vendvotimet për të cilat është rekomanduar që të rinumërohen ka të bëjë me formular të përputhjes së të dhënave dhe rezultateve ka të bëjë me rezultate të kandidatëve dhe në disa raste kemi që nuk është plotësuar kemi mundës të nënshkrimeve nga ana e KVV-e nëse i referohemi tabelës është qartësuar edhe për secilin vendvotim që bëhet fjalë. Dhe kemi raste kur mungon edhe vet formulari por në shumicën e rasteve kemi të bëjmë me mungesën e nënshkrimeve si dhe në formular të pa plotësuar. Për të gjitha këto kategori është rekomandimi që të rinumërohen dhe rinumërimi të jetë i plotë dhe mos të jetë i pjesshëm për arsye se mund të jenë raste të rinumërimit të mëtutjeshme. Këto janë sqarimet sa

i përket gjitha këtyre nga të gjeturat. Sa i përket procedurës së afatit nuk i takon sekretariatit të vlerësoj por vetëm të zbatoj vendimet e KQZ-s, është fjala për dokumentet e skaduara.

**Sami Kurteshi:** Kam dy pyetje që janë teknike tash. Edhe unë vetë kam votuar me kusht, nga personat aty që nuk e kam njohur asnjërin realisht më është ofruar ndihma për ta kryer votimin me gjithë zarf, nuk më është lejuar ta fus votën në kuti pa zarf. Tash unë e dëgjova tek personat me aftësi të kufizuara ose me Covid, ata njerëz kur kanë shkuar tua afrojnë fletëvotimin a ja kanë ofruar edhe zarfin apo jo. Si ka mundur një person me aftësi të kufizuar që është i pa lëvizshëm ai nuk ka mundur ta fus votën pa zarf sepse ja kanë ofruar zarfin. A është defekt i joni, pa kujdesi i njerëzve që kanë qenë aty sepse në vendvotim ku kam qenë unë kanë qenë të kujdesshëm. Kjo është një çështje a konstatojmë që ata në mënyrë arbitrare vetëm me shkuar me fut apo nuk u është ofruar zarfi apo çka ka ngjarë.

**Burim Ahmetaj:** Keni shumë të drejt në këtë aspekt. Mirëpo sekretariati ka bërë trajnim për secilin trup zgjedhor që do të punoj në ditën e zgjedhjeve dhe si rrjedhojë është trajnuar edhe ekipi mobil për mënyrën dhe procedurën se si do të veprohet në të gjitha rastet kur kemi të bëjmë me secilën kategori të nevojave të veçanta, qoftë edhe me të palëvizshëm. Nga rezultati po shihet që nuk është respektuar procedura nga ekipi që kemi dërguar ne dhe si rrjedhojë vota e tyre këtë rast nuk mund të numërohet për shkak të mos respektimit të procedurës nga ekipi. Kjo është përgjigja nga sekretariati.

**Sami Kurteshi:** Megjithatë duhet të konstatohet që nuk është faji i votuesit, por është i personave që ka angazhuar KQZ-ja dhe kanë bërë lëshim. Tash unë e kam një problem themelor, për shkak të gabimeve tona ata janë ekipe mobile. Dikujt i mohohet e drejta e votës ky është problem për mua sepse ata njerëz paguhen dhe kanë përgjegjësi. Unë nuk po e hedh fajin as te ju as diku tjetër por është faji i joni sepse është e pa mundur me hedh votën me kusht personi me aftësi të kufizuara në atë mënyrë dhe duket si arbitrare sikur është zgjuar dhe e ka fut aty dhe nuk ka pasur asnjë pengës, këtu e kam problemin. Tash po i mohohet e drejta e votës sepse ne kemi dështuar ti kryejmë të gjitha përgjegjësit dhe obligimet tona dhe mendoj se kjo duhet të merret parasysh dhe të bëhet si vërejtje dhe ata njerëz të mos përfshihen as në ekipe mobile po as në vendvotime ku ka votim me zarf.

**Sami Hamiti:** Kjo është mbledhja e parë pas procesit zgjedhor. Ne filluam menjëherë me trajtimin e rasteve, mund të konkludojmë se ka qenë një proces zgjedhor prej më të mirëve që është zhvilluar në Kosovë. Rast i një ditë të zgjedhjeve që ka shkuar pa asnjë ekces të dukshëm, një proces zgjedhor duke përfshirë edhe marrjen e materialeve. Për herë të parë shoh një rekomandim që mundet të jetë me 3, 4 faqe jo që i ka 50, 60 faqe ose që i ka 300, 400 kuti. Raste të tilla që po thotë Z. Kurteshi janë aq minore

në këtë rast por ndodhin dhe sigurisht se përgjegjësia është tek trupat zgjedhore jo tek votuesi atë që po e thotë edhe Z. Kurteshi. Por është shumë i vogël në krahasim me proceset e tjera zgjedhore, prandaj mund të konkludojmë që është një proces që ka shkuar shumë mirë. Në ditë votimi prej më të mirave prej kur jam unë në KQZ dhe besoj edhe në procese të tjera paraprake. Atë që e tha Alimi, rekomandimet duhet të ishin më herët unë e kuptoj e di që kryeshefi është shumë i angazhuar edhe me pjesën e QNR-s dhe i duhet më gjatë sepse me tri ndërrime është duke u punuar por megjithatë ekipa me e nda edhe pjesën e raportit pjesës shtesë me rekomandime siç janë. Pjesa sa zarfe duhet të anulohen, kutit të cilat duhet të rinumërohen sepse kur nuk i kemi formularët e nënshkruar normalisht formularët e përputhjes së rezultateve sigurisht se duhet të shkojnë në rinumërim po e shoh që ai numër krahasimisht me zgjedhje të tjera qofshin ato lokale ose për parlament për momentin janë shumë të vogla të shohim tutje. Por po them që ka qenë një proces shumë i mirë dhe uroj që deri në përfundim dhe këtë që e tha Alimi rreth procesimit është mirë që në këto kushte të organizohet pandemi si situatë, megjithatë nuk është trend i keq rrjedhimisht mund të bëhet edhe më mirë por nuk është trend i keq edhe futja e rezultateve dhe formularëve të përputhjes dhe kandidatëve është në trend tash ka mbërri 55-shi për kandidat 60-shi. Sot nesër përfundon dhe besoj që në kohën për sa jam këtu është koha më e shpejt që është proceduar pa problem rezultati.

**Alim Rama:** Ndoshta është më i shpejti unë pajtohem. Por nga përvoja që kam parë poshtë ka hapësirë që të përmirësohet. Sa i përket konstatimit të zarfeve me postë që janë refuzuar, para zgjedhjeve kemi kërkuar që të bëhet publikimi i listës së atyre kandidatëve që janë refuzuar. Ndërkohë ne i kemi në një klik në kompjuter sepse shumë vota në zarf me postë që të anulohen dhe para procesit kemi konstatuar që ka pasur persona që nuk janë trajtuar fare prej KQZ-s, ka qenë një rekomandim nga kolegu Kurteshi këtu që i gjithë vendimi që u morr i KQZ-s për ditën e zgjedhjeve të aprovohet, por së dyti unë kur lexoj edhe statutet e tjera. Personit i refuzohet pako për shkak se nuk ka aplikuar fare në këtë listë dhe periudhën për aplikim, janë 890 dhe ai personi që i ka dorëzuar këto kisha kërkuar sekretaritit që të bëjë edhe njëherë kërkim nëpër e-maile mos kanë aplikuar ose i refuzohet për shkak se është i refuzuar aplikacioni për gjatë periudhës që të evidentohet që ta kemi raportin e saktë se cila votë që pranohet ose refuzohet të dihet arsyeja e saktë pse edhe sekretariat ta kryej punën. Unë e kuptoj që kanë qenë mbi 150.000 e-maile, është një sasi e konsiderueshme e dërgesave por para se të vij vendimi përfundimtar të pranimit ose të refuzimit të shtjerrën të gjitha masat posaçërisht teknike që të shikohet ata votues ka pasur arsye nuk ka qenë lëshimi i KQZ-s që nuk janë në listë.

**Valdete Daka:** Nëse nuk kemi pyetje të tjera. Fillojmë me rekomandimet e QNR-s sepse është rekomandim i parë i cili thotë që rekomandohet të gjitha zarfet e fletëvotimeve me kusht nga vendvotimet të cilat ka mos përputhje të anulohen ato zarfe që nuk janë të nënshkruara dhe zarfet tjera të procesohen si të rregullta që janë në tabelë. Kush është për këtë rekomandim? Rekomandimi i dytë është që të gjitha zarfet e fletëvotimeve me kusht nga vendvotimet si në listë dhe të cilat janë hetuar si materiale të tjera të hetuara nuk rezultojnë se ka mos përputhje të procesohen si të rregullta por tjerat të procesohen të rregullta. Kush është për? Dhe rekomandimi i tretë është që të gjitha vendvotimet në të cilat rezultojnë në formularët e pa nënshkruara nga ana e KVV-e janë të pa plotësuara apo probleme të tjera me shiritat të rinumërohen. Pra rinumërim i plotë e ato janë 12 kuti.

Edhe njëherë duhet ta cekim sepse kjo është hera e parë që kemi kaq pak kuti të rinumëruara për çka i përgëzoj të gjithë dhe shpresoj që mos të kemi kuti në rinumërim pas shpalljes së rezultateve. Kush është për që të rinumërohen këto 12 kuti.

**Sami Kurteshi:** Unë megjithatë e ngrita rastin por nuk e di sa raste janë. Por tek rekomandimi i parë janë sepse, unë e kam këtë problem që e hapa sepse sipas gjitha gjasave votat me kusht që nuk janë fut në zarfe nuk është problem i qytetarit. Problem është i ekipeve tona, unë nuk guxoj ta ngriti dorën prandaj këto raste i përjashtoj nuk mundem ti anuloj votën dikujt që e ka qitur pa zarf kur nuk ka qenë faji i tij. Tash themi janë pak, po janë pak por vota e secilit e ka vlerën e vet mua të më thotë dikush vota jote nuk ka për tu pranuar kam preferenca të forta ose të dobëta politike shqetësohem jashtëzakonisht shumë. Këtu nga rekomandimi i parë unë i përjashtoj rastet e anulimit të fletëvotimit që kanë qenë pa zarfe jo të pa nënshkruara sepse nëse nuk e ka nënshkruar ajo është çështje e tij sepse unë nuk po mund ta konstatoj, sekretariati nuk po konstaton se a ka qenë faji i votuesit.

**Sami Hamiti:** Ajo është votuar dhe përfundoj. Problemet për sqarime votimi i dyfishtë apo votimi me kusht është çështje zarfesh është sigurinë, fshehtësinë e votës. Ajo nëse ka qenë jashtë procesit nuk mund ta marrim të rregullt, ne mundemi vetëm atyre trupave zgjedhor tua ndalojmë ose ti qojmë në përgjegjësi por votën si votë nuk mund ta konsiderojmë si të rregullt këtu është problemi. Ka ndodhur tek trupat zgjedhor por nëse neve një votë e cila është jashtë zarfit të sigurisë atëherë nuk ka fshehtësi të votës. Prandaj është e tillë që nuk mund të procedohet si e rregullt.

**Sami Kurteshi:** Unë pajtohem plotësisht me sqarimin e juaj që ajo votë nuk është e rregullt vetëm unë e kam një problem se nuk po konstatohet se një votues ka mundur ta qes një votë pa zarf vetëm ashtu. Dikush nga personat përgjegjës nuk e ka kryer punën dhe ky është problemi sepse ajo votë është e



vlefshme sepse është një procedurë e cila është zarfi i fshehtësisë nuk ka drejt ta qes ashtu. Për atë janë të obliguar personat përgjegjës që paguhen dhe marrin përgjegjësi.

**Alim Rama:** A ka mundësi që këto vota që janë pa zarf janë hedhur gabimisht aty në votat me kusht që është dashur të hedhen në atë pjesën tjetër ku janë votat e rregullta. kështu që duhet të bëhet edhe analiza e nënshkrimeve në kuti të rregullta

**Burim Ahmetaj:** Faktikisht ato vota i takojnë vetëm votave me kusht dhe nuk mundesh ti përziesh me asnjë votë tjetër sepse çdo vendvotim e ka protokollin e vet, e ka sasinë sa janë pranuar sa janë të përdorura, sa janë brenda kutisë së vlefshme apo të pa vlefshme. Pra praktikisht të gjitha këto nuk mund ti bashkohen asnjë vendvotimi tjetër edhe pse nuk është respektuar procedura prapë se prapë të gjithë votuesit me kusht i regjistrojmë në bazën e të dhënave. Kjo bëhet me qëllim të verifikimit dhe krahasimit me të gjithë votuesit që kanë votuar në ditën e zgjedhjeve dhe pastaj i jepet e drejta e votës së tij duke ju numëruar vota vetëm votuesit që e ka shfrytëzuar vetëm njëherë të drejtën e tij për të votuar qoftë i rregullt apo me kusht. Të gjithë ata që kanë shfrytëzuar të drejtën të votojnë më shumë se njëherë të gjitha ato vota do të refuzohen. Për këtë qëllim i kemi edhe procedurat që janë pak të ngadalshme mirëpo garantojnë saktësi në të gjitha të dhënat.

**Valdete Daka:** E kemi rekomandimin e fundit e ai është që të rritet numri i vëzhguesve nga e njëjta organizatë në të njëjtën kohë varësisht nga aktivitetet që zhvillohen në QNR. Numri i vëzhguesve të rritet për aq njësi të numërimit apo tavolina të numërimit sa janë në QNR dhe në rast se ka nevojë për aktivitete të tjera të lejohen nga e njëjta organizatë edhe dy vëzhgues shtesë në hapësira të tjera. Kush është për?

**Burim Ahmetaj:** Sa tavolina apo njësi të numërimit i organizojmë në hapësirat e QNR-s. Që praktikisht nëse i organizojmë 20 tavolina apo njësi të numërimit nënkupton se do të jenë 20 vëzhgues të cilët do ta vëzhgojnë procesin e numërimit dhe nëse ka aktivitetet në hapësira të tjera lejohen edhe 2 vëzhgues shtesë për të përcjellore aktivitetet qoftë në shërbimin votues apo në hapësirën tjetër të dhënave.

**Alim Rama:** Ne momentalisht i kemi 4 është hapësira në bazë të rendit siç është të votave të mërgatës ka për të vazhduar edhe një kohë të gjatë. Nuk dua ta përcaktoj kohën, hapësira e futjeve të dhënave edhe kjo ka për të vazhduar një kohë kështu që 2 shtesë plus tavolinat unë mendoj se janë pak kështu që kisha rekomanduar të jenë katër siç janë plus për secilën tavolinë ku ka nevojë brenda për rinumërim ose numërimin e votave me kusht.

**Burim Ahmetaj:** Për sekretariatit nuk paraqet problem, mirëpo jemi munduar të paktën ti përshtatemi kushteve pandemike edhe pse është shumë vështirë në atë hapësirë ta respektojmë hapësirën

pandemike. Mirëpo për sekretariatit nuk paraqet problem le të jenë edhe katër shtesë. Aq sa ka tavolina të jenë vëzhgues dhe 4.

**Sami Hamiti:** Nëse janë 12 kuti për rinumërim ajo është çështje dite. Prandaj tavolinat largohen nga rendi i ditës por vazhdon çështja e vlerësimit të votave me post dhe data entry. Kështu që është kjo kërkesa që 4 le të mbesin e çdo tavolinë që bëhet mund të zgjat një dit nuk shoh ndonjë telashe.

**Valdete Daka:** Kush është për këtë rekomandim?

**Sami Kurteshi:** Megjithatë unë më duket e bëra një kërkesë që ky vendimi i KQZ-s për pranimin e votave me dokumente që ju ka skaduar afati që të pranohen nga mërgata. Nuk e di mesa kam dëgjuar nuk është numër i madh është i vogël. Por ne që të mos shkaktojmë diskriminimin në raport me qytetarët nga Kosova ata kanë aplikuar në mënyrë të suksesshme janë konfirmuar në mënyrë të suksesshme. Kishte me qenë diskriminim i hapur nëse nuk i pranojmë votat e tyre si të rregullta siç ka ngjarë në Kosovë që kemi lejuar votimin me dokumente të vlefshme por pa afat.

**Valdete Daka:** Kjo duhet me qenë se pari pikë e rendit të ditës sepse nuk e kemi. Edhe nuk e dimë numrin e saktë të tyre sepse kjo vazhdimisht është duke u ndryshuar tek në fund mund ta dimë sa janë refuzuar për shkak të dokumenteve jo valide dhe nuk e dimë saktë a është jo valide me afat të skaduar.

**Sami Hamiti:** Është e vërtet se ne kemi marr një vendim ditën e votimit për shkak se kanë dalë në vendvotime edhe njerëzit që i kanë pasur të skaduar dhe besoj që shumica absolute e kemi përkrah në kuptimin e asaj që ka qenë një situatë pandemike dhe problem me furnizim të dokumenteve. Por është edhe një e vërtet që në trendin e votimit me postë ato dokumente është cekur edhe në përshkrimin në aplikim që, qytetari që voton nga jashtë dhe është aplikues i suksesshëm nëse nuk e ka dokumentin valid e bashkëngjit dokumentin valid të shtetit nga e nisë. Atje ja kemi dhënë alternativën. Ka ekzistuar ka plotë që nuk e kanë pasur dokumentin por e kanë pasur të drejtën që ta fusin dokumentin valid të shtetit nga e kanë nisur. Atje kemi dhënë një hapësirë. Prandaj është pak specifike, nuk e kam problem që e diskutojmë kur e fusim në rend dite. Ka kohë e shohim e analizojmë por realisht atyre ua kemi dhënë atë mundësi që në dokumentet që i kemi qitur në ueb-faqen tonë që ata nëse dokumentet që janë të Republikës së Kosovës janë me afat të skaduar pse janë jashtë ata vetëm e bashkëngjisnin dokumentet e shtetit nga e nisin votën dhe atëherë është e rregullt.

**Arianit Elshani:** Sa i përket kësaj çështje kisha kërkuar nga sekretariati një përshkrim të saktë të kësaj pike. Të D6, çka nënkuptohet me D6 meqenëse dokumenti jo valid të shtetit të tyre të dokumenteve që i kanë të vendit ku jetojnë apo të dokumenteve të Kosovës prandaj ta kemi një përshkrim të saktë lidhur me këtë

çështje. E pastaj siç e propozoj edhe Z. Kurteshi ta kemi si rend dite edhe e trajtojmë në mbledhjen e radhës. Mirëpo të kemi një bashkim të saktë se çka është nënkuptuar me këtë përshkrim.